



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Prot. 16

Tiranë, më 29.1.2024

Vendim qarkullues i Asamblesë
Nr. 1 datë 29.1.2024
Për miratimin e një kapitulli shtesë
në Statutin e Akademisë së Shkencave, i njësive të përhershme

Referuar nenit 19 pikat 1, 3, 4 (njësitë e kërkim-studimit) të Ligjit nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë;

Mbështetur në nenin 46 të Statutit të Akademisë së Shkencave (njësitë afatgjata të kërkim-studimit);

Në zbatim të VKM nr. 338 datë 31.5.2023 Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj; si dhe të VKM nr. 821 datë 28.12.2023 Për ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave në Republikën e Shqipërisë;

Në vijim e në zbatim të vendimit nr. 61 datë 23.10.2023 të Asamblesë Për ngritjen dhe organizimin e njësive të kërkim-studimit në shkencat albanologjike pranë Akademisë së Shkencave;

Asambleja e Akademisë së Shkencave, me vendimin qarkullues nr. 1 datë 29.1.2024, me pjesëmarrjen në votim të 51 anëtarëve (nga 54 gjithsej) me 47 vota pro, 3 kundra, 1 abstenim (bashkëngjitur praktika me rezultatin e votimit),

Miratoi:

1. Përmbajtjen e Kreut VI, Shtesë në Statut, si në dokumentin bashkëngjitur, hartuar nga Kryesia e ASHSH, për institutet e qendrat

kërkimore të përhershme që përfshihen në rrjetin e njësive kërkimore-shkencore pranë saj.

2. Neni 47 i Statutit i kalon kapitullit VII dhe bëhet neni 67 i këtij kapitulli. Kapitulli VI bëhet kapitulli VII dhe emërtimet e neneve numërtohen 68 e në vijim.

3. Ngarkohet Kryesia të ndjekë hartimin e projekt-rregulloreve të instituteve / qendrave të përhershme dhe të reflektojë në kreun-shtesë në Statut mendimet e vërejtjet e drejtuesve dhe këshillave shkencorë të tyre; si dhe të anëtarëve të Asamblesë, deri në muajin tetor 2024, për t'ia paraqitur për miratim përfundimtar asaj.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

